

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8312
E mërkurë, 3 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Para takimit me Kurtin, AGK-ja i drejtohet me kërkesë publike Antonio Costas

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DNV-ja: PESË DITËT E PARA TË FUSHATËS ME DOMINIM TË LIDERËVE, PA PËRBALLJE MIDIS KANDIDATËVE DHE OFERTAVE POLITIKE

FAQE 4-5



Demokracia në Veprim ka paraqitur të martën vlerësimin analitik mbi pesë ditët e para të fushatës zgjedhore për

zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit 2026. Sipas DnV-së, pesë ditët e para të fushatës ishin me dominim të liderëve,

përdorim të fëmijëve në fushatë, pa përballje midis kandidatëve dhe ofertave politike

AKTUALE



**TRUMPI: MARRËVESHJA ME
IRANIN PRITET TË ARRIHET
GJATË JAVËS SË ARDHSHME** F. 2

**DISPOZITA E LIGJIT PËR
SHTETËSINË, SVEÇLA: KA QENË
PJESË E LEGJISLACIONIT QË NGA
VITI 2008** F. 5

**FLETËVOTIMET PËR ZGJEDHJET E
7 QERSHORIT SHPËRNDAHEN TË
SHTUNËN NË QENDRAT
KOMUNALE TË NUMËRIMIT** F. 3

EKONOMI



**MINTI NË MBROJTJE TË
KONSUMATORËVE: 110 MIJË
EURO GJOBA PËR KEDS-in** F. 8

**LIDHJA E BIZNESEVE E KOSOVËS
HAP ZYRËN E PARË TË
DIASPORËS NË GJENEVË** F. 6

SPORT



**TALENTI I MADH I BAYERN
MUNCHENIT VIZITON FFK-në,
PRITET NGA AGIM ADEMI DHE
FRANCO FODA** F. 11



**PROKURORIA
DHE POLICIA
PARALAJMËROJNË
MASA NDAJ
QYTETARËVE
QË PUBLIKOJNË
VOTËN NË
RRJETET SOCIALE** F. 3

**CERTIFIKATA E ORIGJINËS
'MADE IN KOSOVA' MERR
NJOHJE NDËRKOMBËTARE** F. 8



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI: MARRËVESHJA ME IRANIN PRITET TË ARRIHET GJATË JAVËS SË ARDHSHME

WASHINGTON, 2 QERSHOR - Presidenti amerikan Donald Trump tha për "ABC News" se ai pret që të arrihet një marrëveshje me Iranin për zgjatjen e armëpushimit dhe rihapjen e Ngushticës së Hormuzit brenda javës së ardhshme. Duke folur përmes telefonit me korrespondentin në Uashington të "ABC News", Jonathan Karl, më 1 qershor, Trumpi tha se një marrëveshje e paqes mund të jetë "edhe më e mirë sesa një fitore ushtarake". Një draft-marrëveshje, e ndërmjetësuar nga Pakistani, javët e fundit është përcjellë mes dy palëve, teksa shumë pasiguri përcjellin negociatat.

Një marrëveshje e përkohshme armëpushimi është në fuqi që nga prilli, megjithëse marrëveshja është sfiduar nga sulmet sporadike.

Ka pasur, tha presidenti, "armiqësi të mëdha" nga Irani. "Nuk është gjë e lehtë për ta. Në fakt, nuk është e lehtë as nga pikëpamja jonë. Por, ne po bëjmë aq që duhet bërë", tha Trumpi.

Sa i përket afatit kohor për një marrëveshje të mundshme, presidenti Trumpi tha se "mendojmë se po flasim për javën e ardhshme".

Udhëheqësi amerikan tha se një marrëveshje nuk është arritur deri më tani sepse "më duhet të



siguroj edhe disa pika të tjera". Ditët e fundit Irani dhe Shtetet e Bashkuara kanë këmbyer sulme, me forcat amerikane që

njoftuan për sulme "vetëmbrojtëse" ndaj caqeve iraniane dhe Irani la të kuptohet se kishte sulmuar një bazë

amerikane në Kuvajt.

Përprjekjet për arritjen e një marrëveshjeje vijnë në kohën kur mbyllja e Ngushticës së Hormuzit po pengon në mënyrë të konsiderueshme furnizimet globale me naftë dhe ka bërë që çmimet e energjisë të rriten.

Lufta e Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit me Iranin, e cila filloi më 28 shkurt, ka vrarë mijëra njerëz dhe ka destabilizuar Lindjen e Mesme. Ngushtica e Hormuzit është një rrugë jetike detare përmes së cilës kalon pothuajse 20 për qind e furnizimit botëror me naftë nga Gjiri drejt tregjeve ndërkombëtare.

SHTËPIA E BARDHË NOMINON AMBASADORË PËR NË BOSNJË, SERBI DHE MAL TË ZI

WASHINGTON, 2 QERSHOR - Përmes një dekreti Shtëpia e Bardhë ka nominuar më 1 qershor ambasadorë për në Bosnjë-Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi.

Këto nominime duhet të konfirmohen nga Senati amerikan.

Siç njoftoi Shtëpia e Bardhë, për Bosnjë-Hercegovinë është nominuar Ronald Johnson nga shteti i Masaçusetsit për pozitën e ambasadorit të jashtëzakonshëm dhe fuqplotë të ShBA-së. Johnsoni është gjeneralbrigade në pension në Korpusin e Marinesave të ShBA-së.

Për Serbinë është nominuar Michael Young nga shteti i Uhtas. Gjatë administratës së presidentit George H. W. Bush, Young ka punuar në Departamentin Amerikan të Shtetit si ambasador për çështje të tregtisë dhe mjedisit, si dhe si zëvendëssekretar për çështje ekonomike dhe bujqësore dhe zëvendëskëshilltar ligjor.



Ndërsa për Malin e Zi është nominuar Peter McCoy nga Karolina e Jugut. McCoy gjatë karrierës së tij juridike shërbeu si prokuror shtetëror për Distriktin e Karolinës së Jugut nga viti 2020 deri më 2021, ndërsa më herët kishte punuar si prokuror penal.

Më herët ShBA-ja ka nominuar edhe ambasadorin e saj për Shqipërinë.

Ndërkaq sa i përket Kosovës, Uashingtoni ende nuk ka ndonjë njoftim, teksa

Ambasada Amerikane në Prishtinë aktualisht udhëhiqet nga e ngarkuara me punë, Anu Prattipati, pasi ambasadori paraprak, Jeff Hovenier, përfundoi mandatin trevjeçar në fund të dhjetorit të vitit 2024. Në fund të majit të këtij viti, para Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit amerikan është paraqitur i nominuar për ambasador të ShBA-së në Shqipëri, Eric Wendt.

Para senatorëve ai shpalosi prioritetet kryesore nëse

zgjedhet ambasador, duke thënë se ato do të jenë mbrojtja e qytetarëve amerikanë dhe avancimi i interesave të ShBA-së.

Ndërkaq, sipas njoftimit të 1 qershorit, ShBA-ja ka nominuar edhe ambasadorë për në El Salvador, Azerbajxhan, Mbretërinë e Kamboxhias, Guinenë Ekuatoriale, Moldavi, Indonezi, Bullgari, Republikën e Trinidad dhe Tobagos, Paraguai, Kolumbi, Lituani, Egjipt, Brazil, Ekuador, Gambi, Sierra Leone dhe Kenia.

Procedura e nominimit të ambasadorëve të ShBA-së bazohet në parimin kushtetues të "këshillimit dhe pëlqimit" të Senatit.

Presidenti së pari nominoi kandidatin për ambasador, i cili mund të jetë diplomat karriere ose person i emëruar politikisht. Më pas, nominimi dërgohet në Komitetin e Senatit për Punë të Jashtme, i cili e shqyrton kandidimin.

Komiteti shpesh organizon seanca dëgjimore në të cilat

kandidatët për ambasadorë u përgjigjet pyetjeve të senatorëve lidhur me politikën e ShBA-së, vendin ku do të shërbejë si ambasador dhe tema të tjera të rëndësishme. Komiteti voton për nominimin dhe i dërgon rekomandim përbërjes së plotë të Senatit.

Nëse nominimi miratohet, ai më pas dërgohet për votim në Senat.

Vetëm pasi Senati ta konfirmojë kandidatin me shumicë votash, presidenti amerikan e emëron zyrtarisht ambasadorin.

Ambasadori i ri më pas shkon në vendin pritës dhe dorëzon letrat kredenciale te kreu i shtetit, duke e marrë zyrtarisht detyrën.

Ndryshe nga shumë shtete të tjera, ambasadorët e ShBA-së nuk e fillojnë menjëherë detyrën pas nominimit nga presidenti.

Konfirmimi nga Senati është një mekanizëm i rëndësishëm kontrolli i pushtetit ekzekutiv dhe shpesh mund të zgjasë me javë ose muaj, veçanërisht nëse ka polemika politike rreth kandidatit.

Rusia kryen sulme vdekjeprurëse në Ukrainë

KIEV, 2 QERSHOR - Një sulm në shkallë të gjerë gjatë natës së hënë me dronë dhe raketa nga Rusia në Kiev la të vrarë të paktën katër persona dhe dhjetëra të tjerë u plagosën, përfshirë fëmijë, thanë zyrtarët ukrainas.

Sulmet vijnë disa ditë pasi Moskë paralajmëroi për sulme të reja ndaj kryeqytetit ukrainas, përfshirë edhe ndaj atyre që i quajti "qendra të

vendimmarrjes" në Ukrainë dhe u bëri thirrje shtetasve të huaj dhe diplomatëve që të largoheshin nga qyteti.

Rusia lëshoi 73 raketa dhe 656 dronë gjatë natës, teksa sulme janë regjistruar në 38 lokacione në mbarë Ukrainën, kryesisht në Kiev, thanë Forcat Ajrore ukrainase më 2 qershor. Sipas kryetarit të Kievit, Vitali Klitschko, sulmet e kombinuara të Rusisë në Kiev

më 2 qershor vranë të paktën katër persona dhe plagosën 58 të tjerë, përfshirë fëmijë.

Klitschko raportoi për dëme në ndërtesa banimi, në një klinikë, një pompë benzine, makina dhe infrastrukturë tjetër në disa pjesë të kryeqytetit, si dhe për shpërthimin e disa zjarreve, shembjen e ndërtesave dhe ndërprerje të energjisë elektrike. "Rusia vazhdon



terrorin ndaj civilëve në Ukrainë", tha Avokati i Popullit në Ukrainë, Dmytro Lubinets, përmes një postimi në X.

"Bota duhet të veprojë. Këto sulme duhet të ndalen. Çdo ditë vonesë kushton jetë njerëzish".

FLETËVOTIMET PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT SHPËRNDAHEN TË SHTUNËN NË QENDRAT KOMUNALE TË NUMËRIMIT


EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve tashmë janë vendosur fletëvotimet të cilat janë shtypur në Slloveni dhe janë sjell në Kosovë gjatë këtyre ditëve.

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valmir Elezi, ka thënë se për zgjedhjet e 7 qershorit janë shtypur mbi 1 milionë e 778 fletëvotime.

Edhe për këto zgjedhje sikur ndodh përherë, KQZ-ja ka shtypur më pak fletëvotime sesa numri i votuesve të regjistruar. "Sipas vendimit të KQZ-së, për zgjedhjet e 7 qershorit janë shtypur 1 milionë e 778 mijë e 300 fletëvotime. Nga ky numër, 1 605 000 fletëvotime janë të planifikuara për votimin në vendvotimet e rregullta, 19 450 për votimin me kusht, 13 500 fletëvotime rezervë, dhe 3 500 për votimin e personave me nevoja të veçanta. Edhe në këto zgjedhje, si në të kaluarën, KQZ-ja ka shtypur më pak fletëvotime se numri i përgjithshëm i votuesve dhe kjo mbështetet në analizat e pjesëmarrjes së qytetarëve në votime. Këto fletëvotime aktualisht janë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve dhe në kuadër të përgatitjeve logjistike, të shtunën në mëngjes do të bëhet



shpërndarja e tyre në Qendrat Komunale të Numërimit dhe nga aty të dielën në mëngjes në Qendra të Votimit", ka thënë ai. Sipas Elezit, nga numri i përgjithshëm i fletëvotimeve, për votimin me postë jashtë Kosovës janë shtypur 108 mijë fletëvotime, ndërsa për votimin në përfaqësi diplomatike 28 850 fletëvotime.

Tashmë për votimin në përfaqësi diplomatike është nisur materiali zgjedhor, proces ky i cili do të zhvillohet të shtunën më 6 qershor. "Fletëvotimet për votimin me postë, i cili ka nisur më 21 maj dhe përfundon më 6 qershor,

janë dërguar në adresa të votuesve të regjistruar, ndërkaq fletëvotimet dhe materialet e tjera zgjedhore janë nisur për t'u dërguar në përfaqësi diplomatike, në të cilat do të zhvillohet votimi më 6 qershor. Më 6 qershor procesi i votimit do të zhvillohet në 30 përfaqësi diplomatike për 27 724 votues e regjistruar paraprakisht. Votimi do të mundësohet në 47 vendvotime që iu përkasin 17 ambasadave dhe 13 konsullatave të Republikës së Kosovës të vendosura në 18 shtete të ndryshme të botës. Më 6 qershor përfundon votimi jashtë vendit, përkatësisht

votimi me postë, për 104 488 votuesit e regjistruar për këtë lloj votimi", ka thënë ai.

Më 7 qershor është dita e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës. Procesi i votimit do të zhvillohet në 949 Qendra të Votimit me gjithsej 2 550 vendvotime.

Në 911 Qendra Votimi me 2 498 Vendvotime do të mundësohet votimi i rregullt, ndërkaq në 38 qendra të tjera, nga një për çdo komunë, me 52 vendvotime, do të mundësohet votimi me kusht. Numri i qytetarëve me të drejtë vote në vendvotime në Kosovë është 1 milion e 959 mijë e 962 votues.

KQZ-ja akrediton grupin e dytë me 15 782 vëzhgues për zgjedhjet e 7 qershorit

Komisioni Qendror i zgjedhjeve ka mbajtur të martën mbledhjen e 60, në të cilën ka marrë vendim për akreditimin e grupit të dytë me 15 782 vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të cilat do të mbahen më 7 qershor.

Vëzhguesit e akredituar përfaqësojnë 15 subjekte politike, 8 OJQ vendore, 3 organizata ndërkombëtare, 26 media vendore, 16 media ndërkombëtare, 4 përfaqësi diplomatike.

Në mbledhjen e kaluar, KQZ-ja akreditoi grupin e parë me 761 vëzhgues, të cilët përfaqësojnë 5 OJQ vendore, 1 organizatë ndërkombëtare, 13 media vendore, 7 media ndërkombëtare, 2 përfaqësi diplomatike dhe 1 institucion vendor.

Pas vendimeve nga mbledhja e 60 e KQZ-së, numri i përgjithshëm i vëzhguesve të akredituar për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026, është 16 543 vëzhgues.

PROKURORIA DHE POLICIA PARALAJMËROJNË MASA NDAJ QYTETARËVE QË PUBLIKOJNË VOTËN NË RRJETET SOCIALE

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës kanë pranuar informacione se disa qytetarë, kryesisht nga diaspora, gjatë procesit të votimit me postë kanë fotografuar dhe incizuar votën e tyre dhe të njëjtën e kanë publikuar nëpër rrjete sociale. Kështu bëhet me dije në njoftimin për media të Prokurorisë së Shtetit. Ndër të tjera, thuhet se, pas pranimit të këtyre informatave, Prokurori i Shtetit së bashku me Policinë e Kosovës kanë identifikuar disa persona të cilët kanë kryer veprime të tilla dhe janë në proces të verifikimit dhe trajtimit të të gjitha postimeve eventuale.

"Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës njofton të gjithë qytetarët se këto veprime do të trajtohen dhe secili prej tyre do të mbahet përgjegjës për veprimet e tyre. Po ashtu, Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës fton qytetarët, të cilët e shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votimit, të jenë të kujdesshëm që

vota e tyre në asnjë formë të mos bëhet publike", thuhet në njoftim.

Në njoftimin për medie bëhet me dije se në vazhden e takimeve për procesin zgjedhor, koordinatorja nacionale për zgjedhje, prokuroja Laura Pula, e shoqëruar nga menaxheri i projektit strategjik "Mbrotjtja e votës", Besim Kusari, janë takuar me zëvendës drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, kolonel Fehmi Hoti, i shoqëruar nga kolonel Florie Hajra nga Departamenti i Hetimeve nga Policia e Kosovës dhe nga drejtori i Departamentit të Rendit Publik në Policinë e Kosovës, nënkolonel Arbnesht Ajvazi.

Në këtë takim u diskutua lidhur me planifikimin, vlerësimin dhe angazhimin e Prokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor si dhe për bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Koordinatorja nacionale për zgjedhje, prokuroja Laura Pula,



informoi se tashmë janë të caktuar ekipet kujdestare nga prokurorë të shtetit dhe zyrtarë të sistemit prokurorial, me qëllim të procedimit të çdo parregullsie që mund të ndodhë në këto zgjedhje.

Edhe zëvendës drejtori i

përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Fehmi Hoti, theksoi se edhe Policia e Kosovës ka caktuar ekipet kujdestare policore, të cilët do të kujdesen të ofrojnë siguri dhe mbarëvajtje të procesit zgjedhor.

Në fund të takimit të dyja palët

shprehën përkushtimin e tyre që edhe Prokurori i Shtetit edhe Policia e Kosovës në të gjitha fazat e procesit zgjedhor do të veprojnë në kohë në parandalimin dhe trajtimin e secilit keqpërdorim të mundshëm.



DNV-ja: PESË DITËT E PARA TË FUSHATËS ME DOMINIM TË LIDERËVE, PA PËRBALLJE MIDIS KANDIDATËVE DHE OFERTAVE POLITIKE

Demokracia në Veprim ka paraqitur të martën vlerësimin analitik mbi pesë ditët e para të fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit 2026. Sipas DnV-së, pesë ditët e para të fushatës ishin me dominim të liderëve, përdorim të fëmijëve në fushatë, pa përballje midis kandidatëve dhe ofertave politike

përfitimeve financiare për qytetarët, kanë krijuar avantazh të padrejtë elektoral për partinë në pushtet. Sa i përket ecuresë së fushatës, në pesë ditët e para është vërejtur intensitet më i lartë i aktiviteteve zgjedhore në terren, ku subjektet politike janë përqendruar në tubimet hapëse të fushatës në qendrat kryesore të Kosovës. Janë evidentuar edhe raste të përdorimit të fëmijëve në disa tubime të subjekteve politike, për të cilat tashmë janë deponuar dy ankesa në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP). Për dallim nga rrjedha e qetë e aktiviteteve zgjedhore në terren, fushata në hapësirën online, përkatësisht në rrjetet sociale është dukshëm më e ashpër, për shkak të gjuhës së urrejtjes që shpërfaqet nga përkrahësit e partive. Në anën tjetër, përdorimi i gjuhës fyese dhe diskriminuese nga subjektet politike, ndonëse në nivel më të ulët krahasuar me proceset e mëparshme zgjedhore, tregon se hapësira online vazhdon të

paraqesë sfida serioze për cilësinë e debatit publik”, është shprehur ajo. Zyrtarët e DnV-së kanë theksuar se gjatë periudhës pesëditore janë identifikuar 56 raste që përfshijnë gjuhë urrejtjeje, gjuhë shpifëse ose përçmuese, dezinformim dhe përmbajtje jashtë kontekstit. Nga këto raste, 35 janë klasifikuar si gjuhë urrejtjeje, 19 si gjuhë shpifëse ose përçmuese dhe 2 si dezinformim. Pothuajse gjysma e rasteve të evidentuara kanë për cak gratë pjesëmarrëse në garën zgjedhore. Ndërkaq monitorimi i 152 portaleve informative në gjuhën shqipe dhe serbe ka evidentuar mbi 7 mijë komente që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, që përfaqësojnë rreth 6 % të totalit të komenteve të analizuar gjatë periudhës së monitorimit. “Të dhënat tregojnë një nivel shqetësues të sulmeve verbale në hapësirën online, veçanërisht ndaj grave pjesëmarrëse në procesin zgjedhor, duke ndikuar

negativisht në cilësinë e debatit publik dhe në pjesëmarrjen e tyre në diskursin politik”, ka thënë Haxholli. Ajo ka shtuar se fushata po karakterizohet nga një shkallë e theksuar personalizimi dhe centralizimi, ku liderët politikë dhe kandidatët për pozitat kryesore dominojnë aktivitetet publike dhe komunikimin politik, ndërsa kandidatët për deputetë kanë rol më të kufizuar në paraqitjet publike dhe mediale. “Si rezultat, kandidatët po shfrytëzojnë më shumë rrjetet sociale për promovimin e tyre, përmes publikimit të qëndrimeve, fotografive dhe videove nga takimet me qytetarët. Po ashtu, është evidentuar rritje e përdorimit të videove kreative me efekte vizuale, duke reflektuar angazhimin e kompanive të specializuara të dizajnit dhe prodhimit të përmbajtjes, gjë që tregon për rritje të shpenzimeve në fushatën digjitale. Numri i postimeve që bëhen nga kandidatët e partive arrin deri në 300 në ditë”, ka deklaruar

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Violeta Haxholli nga Demokracia në Veprim ka thënë se në këto zgjedhje po garojnë gjithsej 21 subjekte politike me 902 kandidatë, prej të cilëve vetëm 34 % janë gra. Ajo ka theksuar se për dallim nga zgjedhjet e dhjetorit 2025, subjektet politike kanë rifreskuar listat e tyre të kandidatëve, në disa raste edhe deri 50 %, por pjesëmarrja e grave në lista ka mbetur relativisht e njëjtë. “Numri më i madh i kandidatëve vjen nga komunat me peshë më të madhe elektorale. Kështu, Prizreni prin me numrin më të madh të kandidatëve në nivel vendi me gjithsej 157 kandidatë, pasuar nga Prishtina me 153, Ferizaj

me 77, Peja 68 dhe Fushë-Kosova me 55 kandidatë. Oferta programore e subjekteve politike në këto zgjedhje mund të vlerësohet si riciklim i ofertës së kaluar, por i ambalazhuar në formë të zotimeve, kryesisht të orientuara në fushën e energjisë, pagave, skemave sociale, zhvillimit të infrastrukturës dhe teknologjisë. Shumica e subjekteve politike shqiptare kanë publikuar tanimë këto programe në uebfaqet e tyre zyrtare”, ka thënë ajo. Haxholli ka theksuar se një shqetësim i vazhdueshëm mbetet konkurrenca e pabarabartë në garën zgjedhore. “Përdorimi i resurseve publike para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, përfshirë vendimet e qeverisë në detyrë për shpërndarje të

DISPOZITA E LIGJIT PËR SHTETËSINË, SVEÇLA: KA QENË PJESË E LEGJISLACIONIT QË NGA VITI 2008

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka deklaruar se dispozita e Ligjit për Shtetësinë e Republikës së Kosovës, e cila ka nxitur reagime ditët e fundit, nuk është e re dhe buron nga Kushtetuta e Kosovës dhe Pakoja e Ahtisaarit.

Në një konferencë për medie Sveçla tha se opozita po kritikon një dispozitë që vetë e kishte bartur në dispozitat themelore të Kushtetutës në vitin 2012. "Ditëve të fundit janë bërë deklarime të shumta lidhur me Ligjin për Shtetësinë e Republikës së Kosovës. Për shkak të interesimit publik, është e rëndësishme të sqarohen disa fakte themelore, posaçërisht lidhur me nenin 31 të këtij ligji. Së pari, neni 31 i Ligjit për Shtetësinë e vitit 2026 nuk është një dispozitë e re. Ky nen është pjesë e dispozitave themelore kushtetuese të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 155 që derivon nga Pakoja e Ahtisaarit. Kjo e drejtë nuk është krijuar apo njohur nga kjo qeveri dhe nuk është futur për herë të parë me ligjin e ri, ashtu siç eksponentët e opozitës po e proklamojnë", tha ai.

Sveçla theksoi se kjo dispozitë ka qenë pjesë e legjislacionit që nga viti 2008. "Kjo e drejtë, e cila parasheh se Republika e Kosovës ua njeh të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe shtetësia që kanë, të gjithë qytetarëve që ishin pjesë Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës më 1 janar të vitit 1998, si dhe pasardhësve të



tyre të drejtpërdrejtë, buron nga propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës i njohur si Pakoja e Ahtisaarit, të cilën, siç të gjithë e dini, ne e kemi kundërshtuar në mënyrë fundamentale. Më pas, e njëjta është përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka qenë pjesë e pandryshuar e legjislacionit tonë për shtetësinë që nga viti 2008", tha ai.

Ai akuzoi qeveritë e kaluara për bartjen e kësaj dispozite në pjesën themelore të Kushtetutës. "Ndërsa në vitin 2012, në vend që kjo dispozitë të hiqej nga Kushtetuta dhe të kishte të njëjtin fat si dispozitat e tjera kalimtare, opozita e tanishme, e cila ishte në pushtet në atë kohë, përmes ndryshimeve kushtetuese vendosi ta bartë këtë dispozitë te dispozitat themelore të Kushtetutës me qëllim që ta bëjë pjesë të përhershme të rendit kushtetues të Republikës

së Kosovës. Pra në thelb, ajo që opozita sot po e kritikon, e ka burimin pikërisht këtu. Çfarë nënkupton se ata ose nuk kanë qenë fare të vetëdijshëm për atë që kanë bërë dhe votuar, ose kanë pasur pikërisht qëllimin për të cilin po na akuzojnë ne sot", tha ai.

Drejtori i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Qëndrim Bytyqi, tha se formulimi i nenit aktual është i njëjtë me atë të Kushtetutës. "Këtu në këtë prezantim i kemi vendosur në katër kolona, fillimisht Kushtetutën, nenin 155, i cili e parasheh këtë të drejtë që nga viti 2008. Pastaj ligjin e vitit 2013 për shtetësi, Ligjin 04/L-215 që ka qenë në fuqi deri më 22 maj 2026, edhe Ligjin e parë për Shtetësi pas miratimit të Kushtetutës, që është miratuar në vitin 2008. Ky është neni i njëjtë që është në të katër aktet. Aktualisht është neni 31, në ligjin paraprak ka qenë neni

32", tha ai.

Bytyqi tha se ligji i ri nuk e konsideron automatikisht shtetas çdo person, por njeh të drejtën për shtetësi sipas kriterëve. "Nëse e shohim formulimin e ligjit, nenin 31 të ligjit aktual: 'Republika e Kosovës ua njeh të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tanishëm, dhe shtetësia që kanë, gjithë qytetarëve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës më 1 janar 1998, dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë.' Formulimi i njëjtë, po besoj mundeni me e parë, është copy prej dispozitës së Kushtetutës, neni 155, paragrafi 2 të Kushtetutës. Një formulim i ngjashëm, në materie të njëjtë por me disa formulime pak më ndryshe ka qenë në vitin 2013 edhe 2008, ku këtu besoj mundeni me parë dallimin

kryesor, që tek ligji i vitit 2013 dhe 2008 është përdor termi "konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës", njësoj mundeni me parë edhe te ligji i vitit 2008 'konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës'", tha ai.

Ai shtoi se ligji i ri është harmonizuar me formulimin kushtetues. "Pra ligji, për dallim prej Kushtetutës, për shkak që Kushtetuta e ka njohur të drejtën, e njohja e të drejtës nënkupton që duhet të plotësohen kushtet se si një person mund të arrijë deri te fitimi i shtetësisë, ndërsa ligji i vitit 2013 dhe 2008 kanë shkuar përtej Kushtetutës për shkak që i kanë konsideruar shtetas të Republikës gjithë këta persona. Në ligjin e vitit 2026 që tash ka hyrë në fuqi, e shihni këtu që është formulimi i njëjtë sikur në Kushtetutë, që domethënë ligji ua njeh të drejtën e shtetësisë, por që duhet të plotësohen kriteret", tha ai.

ajo. Kurse në aspektin e sponsorizimit të përmbajtjes në "Facebook", vlerat e shpenzuara gjatë pesë ditëve variojnë nga 10 000 deri në 12 000 euro në total, duke treguar një shtim të dukshëm të investimeve në komunikimin online.

Haxholli ka theksuar se këto trende tregojnë se rrjetet sociale po shndërrohen në një nga platformat kryesore të komunikimit politik si për shpërndarjen e mesazheve, po ashtu edhe për ndërtimin e imazhit publik të kandidatëve. Sa i përket hapësirës në medie, dominojnë emisione apo debate me vetëm një subjekt

ose një kandidat përballë gazetarëve (gjithsej 28 emisione), ndërsa debatet me analistë numërojnë 17. "Emisionet me pjesëmarrjen e më shumë subjekteve janë 9, ndërsa ballafaqimet e drejtpërdrejta mes dy kandidatëve mbeten shumë të rralla, me vetëm 2 raste. Në debatet televizive vërehet një pabarazi e theksuar gjinore, ku burrat përbëjnë rreth 80 % të pjesëmarrësve, ndërsa gratë vetëm 20 %, kurse në kronikat zgjedhore, hapësira mediale paraqitet më e balancuar në shikim të parë, me 60 % të kohës së dedikuar për burra dhe 40 % për gra. Në kontekstin e administrimit të zgjedhjeve,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po vazhdon aktivitetet për organizimin e zgjedhjeve të 7 qershorit, kryesisht me një vendimarrje konsensuale", ka thënë Haxholli. Megjithatë, sipas DnV-së, është shqetësues vendimi i fundit i KQZ-së për t'ua lënë në diskrecion partive politike çështjen e emërimit të komisionarëve - ndonëse në këto lista mund të ketë komisionarë që po hetohen për keqpërdorime në zgjedhjet e dhjetorit të 2025-s. "Kjo bie ndesh me standardet e integritetit zgjedhor", ka thënë Haxholli.

Ndërsa sa iu përket mekanizmave të ankesave,

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia ka pranuar tri ankesa nga subjektet politike, prej të cilave dy lidhen me përdorim të fëmijëve në fushatë dhe një me gjuhë nxitëse dhe urrejtëse. "Është vendosur vetëm për një rast, ku ankesa është refuzuar e pabazuar. Në përgjithësi, gjetjet e pesë ditëve të para të fushatës tregojnë se procesi zgjedhor po zhvillohet në një ambient përgjithësisht të qetë dhe konkurrues, por që vazhdon të përballet me sfida që lidhen me barazinë e garës, cilësinë e debatit publik dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes në hapësirën digjitale. Në këtë kontekst u bëhet thirrje

subjekteve politike që të përqendrohen në ofertat e tyre programore dhe në prezantimin e zgjedhjeve konkrete për qytetarët, duke iu përmbajtur rreptësisht rregullave dhe standardeve për gjuhën e përdorur në fushatë, si dhe duke shmangur përdorimin e resurseve publike dhe përfshirjen e fëmijëve në aktivitetet zgjedhore. Në të njëjtën kohë, qytetarët dhe votuesit inkurajohen që të informohen për programet e subjekteve politike dhe të përfshihen më shumë në debate përmbajtjesore mbi politikën publike dhe zgjedhjet që ofrohen në këtë proces zgjedhor", ka thënë Haxholli.

Prattipati viziton Aleancën, takohet me kryetarin e ri Ardian Gjini

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka pritur në takim të Ngarkuarën me Punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Anu Prattipati.

Gjini e ka falënderuar Prattipatin për vizitën si dhe për urimet e saj me rastin e

marrjes së detyrës në krye të Aleancës. "Gjatë bashkëbisedimit, ndamë pikëpamjet tona për proceset aktuale politike, e në veçanti për procesin e zgjedhjeve në Kosovë. Po ashtu, e sigurova znj. Prattipati se ndryshimi i fundit në lidhshmëri me Aleancën nuk nënkupton në asnjë formë ndryshim të

orientimit tonë strategjik dhe të bindjeve tona të prera për rrugën që duhet të ndjekim. Përgjatë bisedës, shpreha mirënjohjen time të thellë për rolin jashtëzakonshëm që Shtetet e Bashkuara kanë luajtur në të gjitha fazat historike dhe shtetndërtuese të Kosovës", ka shkruar Gjini në "Facebook".



LIDHJA E BIZNESEVE E KOSOVËS HAP ZYRËN E PARË TË DIASPORËS NË GJENEVË

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Lidhja e Bizneseve të Kosovës ka hapur zyrtarisht Zyrën e parë të Diasporës në Gjenevë, një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ekonomik me mërgatën shqiptare.

Ceremonia e hapjes së zyrës u zhvillua me pjesëmarrjen e kryetarit të Lidhjes së Bizneseve të Kosovës, Besart Dreshaj dhe nënkryetarit Hashim Dëshishku, të cilët theksuan rëndësinë strategjike të këtij projekti për lidhjen e diasporës me ekonominë e Kosovës. Me këtë rast, kryetari Besart Dreshaj nënshkroi vendimin për funksionimin e zyrave të

diasporës dhe emëroi Xhavit Islami koordinatori i Zyrës në Gjenevë.

Ky projekt synon të afrojë më shumë diasporën me ekonominë e Kosovës, duke krijuar mundësi të reja për investime, rrjetëzim biznesor dhe promovim të produkteve të Kosovës në tregjet ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij funksionimi, zyra e re në Gjenevë do të shërbejë si pikë kontakti për: lehtësimin e investimeve në Kosovë dhe nga diaspora; krijimin e bashkëpunimeve ndërmjet bizneseve vendore dhe atyre të diasporës; ofrimin e informatave mbi mundësitë

investuese; dhe promovimin e produkteve kosovare jashtë vendit.

Në këtë takim u tha se një falënderim i veçantë i drejtohet Konsullit të Nderit të Maqedonisë së Veriut, Zaim Jashari, për bashkëpunimin e ngushtë, mbështetjen dhe mundësimin e hapësirës së zyrës, duke dhënë një kontribut të çmuar në realizimin e këtij misioni.

Pas Gjenevës, Lidhja e Bizneseve të Kosovës planifikon zgjerimin e rrjetit të zyrave të diasporës edhe në vende të tjera, me synim fuqizimin e bashkëpunimit ekonomik dhe institucional me mërgatën shqiptare.



PËRURORHET SHËRBIMI I HEMODIALIZËS NË SPITALIN E PËRGJITHSHËM NË GJILAN

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Spitali i Përgjithshëm në Gjilan po kalon nëpër një transformim modern, duke investuar në infrastrukturë dhe pajisje mjekësore, ku synojmë të përmbushim çdo kriter që plotëson standardet evropiane të kujdesit shëndetësor.

Drejtori i Spitalit, dr. Afrim Cana, së bashku me ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Arben Vitia, kryetarin e komunës, Alban Hyseni, dhe drejtorin e ShSKUK-së, Elvir Azizi, përuruar Shërbimin e Hemodializës.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka theksuar se angazhimi i tyre do të vazhdojë në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor. "Përmes këtyre investimeve synojmë ta rrisim cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin e kujdesit shëndetësor, duke siguruar që pacientët tanë të marrin shërbime sa më cilësore, më të qasshme dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të trajtimit", ka



thënë ai. Drejtori i Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, Afrim Cana, ka theksuar se ndihet i lumtur për projektet e realizuara sipas planit të punës. "Ky projekt, si Hemodializa, është një nga projektet tona tashmë i realizuar sipas

standardeve evropiane, përmes angazhimit të përbashkët me ShSKUK-në dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Menaxhmenti i ka kushtuar rëndësi të veçantë këtij shërbimi specifik, duke investuar në përmirësimin e infrastrukturës, pajisjeve mjekësore dhe ngritjen e

kapaciteteve profesionale të stafit. Qëllimi ynë ka qenë dhe mbetet që pacientët të marrin këtë shërbim në kushte sa më të mira të mundshme, në një mjedis modern dhe funksional, me siguri maksimale dhe kujdes të vazhdueshëm shëndetësor", ka thënë ai.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka mirëpritur investimet në shëndetësinë e Gjilanit, duke vlerësuar ato si një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies së qytetarëve.

Drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, ka thënë se vazhdon mbështetja për të gjitha spitalet e përgjithshme dhe institucionet shëndetësore në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tyre për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore dhe avancim të kapaciteteve profesionale.

Udhëheqësi i Shërbimit të Hemodializës, dr. Afrim Bekteshi, ka thënë se gjatë vitit 2025 në këtë shërbim janë realizuar gjithsej 6 184 trajtime të dializës, me një mesatare prej 515 pacientësh në muaj dhe rreth 25 pacientë në ditë. Ai bëri me dije se gjatë muajve të verës numri i pacientëve rritet për shkak të ardhjes së bashkatdhetarëve.

Përurohet Qendra e Kërkim-Shpëtimit dhe hapja e kampingut stërvitor në Ujman

MITROVICË, 2 QERSHOR - Kryetari i komunës, Faton Peci, së bashku me kryeministrin në detyrë Albin Kurti, kanë përuruar objektin e Qendrës së Kërkim-Shpëtimit në Ujman. Në këtë ngjarje të rëndësishme morën pjesë edhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, si dhe u. d. i drejtorit të

Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave (AME), Shefki Abdullahu.

Në të njëjtën ditë, më 1 Qershor - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, u bë edhe hapja e kampingut stërvitor, i cili synon aftësimin praktik të pjesëmarrësve, rritjen e gatishmërisë për

intervenime në raste rreziku dhe zhvillimin e kapaciteteve për operacione kërkim-shpëtimit.

Kryetari Faton Peci potencoi se Ujmani, pasuria kryesore e vendit tonë, tashmë i lirë, po u shërben të gjithëve duke krijuar mundësi edhe për të rinjtë tanë.



Qeveria themelon Fondin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ndan mbi 550 mijë euro për shëndetësi dhe teknologji

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike të 22-të në formë elektronike, në të cilën ka marrë disa vendime që lidhen me sektorin e shëndetësisë dhe mbështetjen e aktiviteteve të teknologjisë dhe inovacionit. Në këtë mbledhje ekzekutivi ka themeluar Fondin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të Republikës së Kosovës, një mekanizëm i paraparë për

financimin dhe menaxhimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore. "Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, ka zhvilluar mbledhje elektronike, në të cilën ka: Themeluar Fondin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të Republikës së Kosovës. Miratuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 400,000.00 euro (katërqind mijë euro), për

zbatimin e Marrëveshjes me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 153,000.00 euro (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë euro) me qëllim të mbështetjes së realizimit të tri (3) eventeve në kuadër të 'OctoberTech' - iniciativë që bashkon ngjarjet më të mëdha të teknologjisë dhe inovacionit në Kosovë", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



PARA TAKIMIT ME KURTIN, AGK-ja I DREJTOHET ME KËRKESË PUBLIKE ANTONIO COSTAS



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, që përfaqëson mbi 700 gazetarë në Kosovë, i është drejtuar publikisht me këtë kërkesë presidentit të Këshillit Evropian, Antonio Costa, me rastin e vizitës së tij në Kosovë.

AGK-ja kërkon nga Costa që, në takim me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, të diskutojë nevojën për respektimin e lirisë së medias dhe të shprehjes nga ana e qeverisë dhe institucioneve të Kosovës. Sipas AGK-së, Kosova ka shënuar një rënie dramatike të lirisë së medias në vitet e fundit, e dokumentuar nga raporte

ndërkombëtare, duke përfshirë edhe vizitën në mars të Platformës për Sigurinë e Gazetarëve të Këshillit të Evropës. "Qeveria e zotit Kurti dhe partia e tij politike, Vetëvendosje, janë angazhuar në fushata të vazhdueshme denigrimi kundër gazetarëve dhe punonjësve të mediave për shkak të punës së tyre. Kjo e ka bërë klimën e të bërit gazetari në Kosovë më të rëndën në vitet e fundit. Institucione që do të duhej të ishin të pavarura, si Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Radio Televizioni i Kosovës, janë vënë nën ndikim të drejtpërdrejtë politik nga

Qeveria, nëpërmjet emërimit të bordeve në procese të komprometuara. AGK-ja shpreson që z. Costa do t'ia rikujtojë kryeministrin Kurti se respektimi i lirisë së medias është kyç në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, të cilin e aspiron shumica dërrmuese e popullit të Kosovës. Gazetarët dhe mediat në Kosovë vazhdojnë të bëjnë një punë jetike në ofrimin e informacionit në interes të publikut, duke luajtur rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e një vlere themelore të demokracisë evropiane", ka njoftuar AGK-ja.

NGA 9 QERSHORI HYN NË FUQI UDHËZIMI I RI PËR CKP-NË, ZHBLLOKOHET CERTIFIKIMI I SHOFRERËVE TË KAMIONËVE DHE AUTOBUSËVE

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Ministri në detyrë i Infrastruktursë dhe Transportit, Dimal Basha, ka njoftuar se është nënshkruar Udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) nr. 15/2024, i cili do të hyjë në fuqi më 9 qershor. Sipas Bashës, udhëzimi i ri adreson problemet me të cilat janë përballur shoferët e kamionëve dhe autobusëve që operojnë në transportin ndërkombëtar për shkak të mungesës së një baze të qartë ligjore për lëshimin e Certifikatës së Kompetencës Profesionale (CKP). "Që nga



marrja e mandatit si Ministër i Infrastruktursë dhe Transportit, kam pranuar shqetësime të

shumta nga shoferët dhe operatorët e transportit lidhur me vështirësitë e krijuara nga

mungesa e bazës së qartë ligjore për lëshimin e Certifikatës së Kompetencës Profesionale (CKP)", ka shkruar Basha në "Facebook".

Ai ka bërë me dije se kjo situatë kishite shkakuar gjoha të shumta për shoferët dhe vështirësi gjatë kalimit të kufijve.

Ministri Basha tha se menjëherë pas marrjes së detyrës është formuar një grup punues dhe janë angazhuar kapacitetet profesionale për trajtimin e çështjes me prioritet. "Prandaj, në kohë rekord kemi hartuar dhe finalizuar Udhëzimin Administrativ për Ndryshimin

dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) nr. 15/2024, të cilin e nënshkrova sot", ka deklaruar ai. Sipas Bashës, me hyrjen në fuqi të udhëzimit të ri javën e ardhshme do të zhblokohet procesi i certifikimit të shoferëve fillestarë me Certifikatën e Kompetencës Profesionale. "Nga java e ardhshme kur Udhëzimi hyn në fuqi, do të zhblokohet përfundimisht procesi i certifikimit të shoferëve fillestarë me Certifikatën e Kompetencës Profesionale (CKP), duke eliminuar pengesat e kamotshme", ka theksuar ministri.

Universiteti i Prishtinës vazhdon të hapë vende të reja pune për personel akademik

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Universiteti i Prishtinës ka shpallur edhe një konkurs tjetër për personel akademik, profesorë dhe asistentë. "Kandidatët që aplikojnë për këto pozita duhet të plotësojnë kërkesën për aplikim, të kenë të përgatitur CV-në e plotë me të gjitha arritjet akademike, diplomat e të gjitha niveleve të studimit, dëshmitë për

publikimet shkencore e profesionale dhe dëshmitë për përvojën dhe aftësinë në mësimdhënie, duke paraqitur një portfolio të punës profesionale dhe një deklaratë të filozofisë së mësimdhënies. Ata gjithashtu këtyre dokumenteve duhet t'u bashkojnë edhe certifikatën e lindjes dhe dëshminë nga gjykata që nuk janë të dënuar",

ka njoftuar UP-ja. Konkursi është i hapur nga 2 deri më 16 qershor në orën 16:00.

Universiteti i Prishtinës ka ftuar profesionistët dhe shkencëtarët nga vendi, rajoni dhe e gjithë bota që të aplikojnë dhe të futen në garë për këto vende të lira për personel akademik, profesorë dhe asistentë. "Universiteti i Prishtinës është një

punëdhënës i drejtë dhe i përgjegjshëm që garanton përzgjedhje të kandidatëve më meritore, në bazë të transparencës, meritokracisë dhe duke zbatuar legjislacionin në fuqi në të gjitha fazat e konkursit publik. Në këtë frymë, duke garantuar ligjshmëri dhe meritokraci, Universiteti i Prishtinës mirëpret sa në shumë aplikante", ka njoftuar UP-ja.



MINTI dhe komuna e Gjilanit nënshkruajnë marrëveshje për projektimin e Parkut Industrial


PRISHTINË, 2 QERSHOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) dhe komuna e Gjilanit kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për projektimin e Parkut Industrial në Gjilan, duke shënuar hap të rëndësishëm drejt zhvillimit ekonomik dhe industrial të komunës.

Ministrja e Industrisë,

Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, së bashku me kryetarin e komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, formalizuan bashkëpunimin vetëm pak javë pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpalljen e Parkut Industrial në Gjilan.

Ky projekt synon krijimin e kushteve më të favorshme për investime, zgjerimin e

kapaciteteve prodhuese, zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Përmes marrëveshjes, palët do të bashkëpunojnë në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për projektimin dhe zhvillimin e parkut industrial sipas standardeve bashkëkohore të zhvillimit të qëndrueshëm.



CERTIFIKATA E ORIGJINËS 'MADE IN KOSOVA' MERR NJOHJE NDËRKOMBËTARE

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka njoftuar se Certifikata e Origjinës "Made in Kosova" tashmë është e njohur ndërkombëtarisht, një zhvillim që e ka cilësuar "arritje të rëndësishme dhe historike për ekonominë e Republikës së Kosovës". Sipas OEK-ut, në Paris institucioni është "akredituar zyrtarisht nga Oda Ekonomike Ndërkombëtare dhe Federata Botërore e Odave Ekonomike për lëshimin e Certifikatave të Origjinës me njohje globale". "Ky proces përfaqëson rezultat të një pune të gjatë institucionale dhe profesionale, me qëllim forcimin e pozitës së Kosovës në tregtinë ndërkombëtare dhe rritjen e besueshmërisë së produkteve kosovare në tregjet globale", thuhet në njoftimin për medie. Oda Ekonomike thekson se me

këtë akreditim, për herë të parë në historinë e vendit, certifikatat e origjinës të lëshuara nga ky institucion do të kenë vlefshmëri të njohur ndërkombëtarisht. "Për herë të parë në historinë e Republikës së Kosovës, Certifikatat e Origjinës të lëshuara nga Oda Ekonomike e Kosovës do të kenë validitet ndërkombëtar të pranuar, duke mundësuar një prezantim më të fuqishëm të produkteve vendore në tregjet botërore", thuhet më tej në njoftim.

Sipas OEK-ut, ky hap strategjik pritet të kontribuojë në forcimin e eksportit të produkteve të Kosovës, rritjen e kredibilitetit ndërkombëtar të bizneseve vendore, digjitalizimin dhe modernizimin e shërbimeve tregtare si dhe në mbështetjen e drejtpërdrejtë të prodhuesve dhe eksportuesve të Kosovës.



"Ky zhvillim shënon një moment të rëndësishëm për ekonominë e vendit dhe hap

perspektiva të reja për integrimin më të thellë të Kosovës në tregjet

ndërkombëtare", theksohet në njoftimin e Odës Ekonomike të Kosovës.

MINTI NË MBROJTJE TË KONSUMATORËVE: 110 MIJË EURO GJOBA PËR KEDS-IN



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Edhe gjatë muajit maj ka vazhduar verifikimi i njehsorëve elektrikë të konsumatorëve që kanë paraqitur ankesa pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit. Sipas të dhënave nga Agjencia e Metrologjisë e Kosovës, nga verifikimet e realizuara është konstatuar se 18 njehsorë kanë qenë me afat të skaduar të validitetit, dy njehsorë kanë rezultuar me miratim tipi të tërhequr, ndërsa 30 njehsorë kanë pasur pasaktësi në datë dhe orë.

Bazuar në gjetjet e

evidentuara dhe në përputhje me Ligjin për Metrologjinë, Inspektorati Qendror i Tregut ka shqiptuar ndaj KEDS-it gjoba në vlerë prej 110 000 eurosh.

Ndërkohë, raportet zyrtare të verifikimit janë dorëzuar edhe te KESCO me qëllim të kompensimit të konsumatorëve të dëmtuar. Procesi i verifikimit të njehsorëve do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme deri në trajtimin dhe shqyrtimin e plotë të të gjitha ankesave të paraqitura në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Rriten të hyrat dhe shpenzimet e qeverisë

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Llogaritë Qeveritare për tremujorin e parë (TM1) 2026. Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

Gjithsej të hyrat e Qeverisë së Përgjithshme në TM1 2026 ishin 841.8 milionë euro, derisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM1 2025) të hyrat e qeverisë ishin 687.9 milionë euro.

Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë: Tatimet

në produkte që paraqesin rreth 68 %; Tatimet rrjedhëse në të ardhura paraqesin rreth 17 %; Aktivet dhe detyrimet financiare paraqesin rreth 7 %, ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave.



IVANKA TRUMP FLET PËR INVESTIMET NË SHQIPËRI: SI GJETA SAZANIN DHE LAGUNËN NË ANËN TJETËR



Ivanka Trump, vajza e Presidentit të Shteteve të Bashkuara, ka treguar anën e saj emocionale lidhur me investimin që po bën së bashku me bashkëshortin në ishullin e Sazanit.

Në podkastin e David Senra, në episodin e titulluar "Ivanka Trump në ndërtimin e një jete autentike", ajo sqaroi fillimisht se si e zbuloi këtë ishull. Në mënyrë krejt rastësore, dhe që i mbeti në mendje që nga momenti i parë kur e pa.

"Është një ishull privat i pabesueshëm, i bukur, me sipërfaqe 1.400 hektarë, në mes të Mesdheut. Ishim në jahtin e një miku dhe u ndalëm për të notuar. Në fakt, kështu e gjetëm. Notuam deri në ishull. Ecëm zbatuar deri në majë dhe thjesht u magjepsëm; dhe ai vend ka mbetur në mendjet tona që prej asaj kohe", tha ajo.

Ideja për investimin, ama, nuk erdhi "sa hap e mbyll sytë". Trump sqaroi se vetëm pas disa vitesh u krijua mundësia për të zhvilluar projektin. Ajo i kushtoi rëndësi integritetit të plotë të arkitekturës me terrenin e ishullit.

"Gjatë shumë viteve, ne krijuam mundësinë për të ndihmuar në realizimin e potencialit të tij dhe për ta transformuar, por me shumë përmbytje dhe kujdes, sepse toka është aq e bukur, sa që arkitektura duhet të integrohet

plotësisht në të, pothuajse të ngrihet prej saj", tha Trump. Për Ivankën, ky investim nuk shihet thjesht si një biznes, por edhe si një mënyrë jetese, një "manifestim i prekshëm", siç e cilësoi ajo.

"E dini, për mua kjo nuk është as një biznes, pavarësisht përmasës së tij. Ne kemi jo vetëm ishullin, por edhe pesë milje vijë bregdetare përballë tij. Një gadishull i bukur me një lagunë në një anë, oqeanin

në anën tjetër dhe plazhe të bukura me rërë të bardhë. Për mua, kjo ndihet më shumë si një sfidë se çdo gjë tjetër. Është kulmi i gjithë përvojës sime në pasuritë e paluajtshme, i të gjitha udhëtimeve të mia dhe i shumë reflektimeve mbi mënyrën se si dua të jetoj, si mendoj se njerëzit gjithnjë e më shumë duan të jetojnë, dhe përpjekja për të ndërtuar diçka që është një manifestim i prekshëm i kësaj", u shpreh ajo.

Trump theksoi se realizimi i projektit kërkon një vizion të qartë dhe bashkëpunimin e disa prej arkitektëve më të njohur në botë. Sipas saj, gjatë vizitave në ishull, ajo ka punuar nga afër me profesionistë që i konsideron mjeshtër të vërtetë të fushës së tyre, me synimin për të krijuar një zhvillim që respekton plotësisht natyrën dhe karakterin unik të zonës.


"Kjo kërkon shumë vizion.

Kërkon bashkëpunimin e disa prej mjeshtërve më të mëdhenj që ekzistojnë. Sapo isha atje duke ecur nëpër tokë, thjesht duke u përpjekur të jem me të dhe ta përfytyroja atë, së bashku me disa nga arkitektët më të mëdhenj të gjallë të kohës sonë, mjeshtër të vërtetë të zanatit të tyre. Njerëz me integritet kaq absolut, sa që nuk do të ketë asnjë kompromis. Dhe kjo është diçka që ne duam të krijojmë atje. Prandaj jemi shumë të emocionuar", tha ajo.

Duke shpjeguar se çfarë nënkupton me "integritet absolut", ajo u shpreh se artistët dhe krijuesit më të mirë nuk bëjnë kompromis me vizionin e tyre. Trump vlerësoi profesionistët që refuzojnë të ulin standardet e cilësisë apo të sakrifikojnë idetë e tyre krijuese për arsye praktike ose komerciale, duke shtuar se pikërisht ky përkushtim ndaj përsosmërisë është elementi që dëshiron të karakterizojë projektin në Mesdhe.

"Kur punon me artistë të vërtetë, pavarësisht mediumit të tyre, qoftë një telajo, pasuritë e paluajtshme, një shtëpi apo muzika, ata nuk bëjnë kompromis. Integriteti i tyre është i saktë. Dhe ata do ta shtyjnë veten përtej kufijve. Do t'i shtyjnë edhe të gjithë njerëzit rreth tyre", përfundoi ajo.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Jeronimo Sarin rikthehet te Sigal Prishtina pas nëntë vjetësh

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Sigal Prishtina ka vendosur t'ia besojë sërish drejtimin e skuadrës trajnerit Jeronimo Sarin. Strategu kroat është emëruar në krye të bardhekaltërve, duke u rikthyer në kryeqytet pas nëntë vjetësh.

Sarin rikthehet në Kosovë vetëm gjashtë muaj pas largimit të fundit nga basketbolli i Kosovës, ndërsa tashmë do të nisë një kapitull të ri me klubin më të trofeshëm në vend. Trajneri kroat është një emër i njohur për tifozët prishtinas, pasi

kishte drejtuar Sigal Prishtinën edhe në të kaluarën, duke lënë gjurmë në periudhën e tij të parë në krye të skuadrës. Me emërimin e Sarinit, Prishtina synon të ndërtojë një skuadër konkurruese për edicionin e ri, me objektiva të qarta për

trofetë vendorë dhe paraqitje sa më të suksesshme në garat ndërkombëtare. Ditët në vijim pritet të jenë mjaft aktive për klubin nga kryeqyteti, i cili po punon në kompletimin e stafit dhe të përforcimeve për sezonin 2026/27.



TALENTI I MADH I BAYERN MUNCHENIT VIZITON FFK-në, PRITET NGA AGIM ADEMI DHE FRANCO FODA

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Në ambientet e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), presidenti FFK-së, Agim Ademi, ka pritur në takim futbollistin e ri dhe të talentuar, Erblin Osmani, pjesë e gjigantit gjerman Bayern Munich. "Erblini, i cili ndodhet në Kosovë për pushimet e verës, vizitoi FFK-në dhe ndoqi nga afër

seancën stërvitore të Kombëtares së Kosovës në stadiumin 'Fadil Vokrri', duke u njohur me punën dhe atmosferën që karakterizon ekipin tonë kombëtar. Vizita e tij është dëshmi e lidhjes së fortë mes talentëve kosovarë që po shkëlqejnë në futbollin evropian dhe rrënjëve të tyre në vendlindje", ka shkruar



Ademi në "Facebook". Presidenti Ademi ka theksuar se Erblini është shembull i gjeneratës së re që po e çon emrin e Kosovës në nivelet më të larta të futbollit botëror. "Federata e Futbollit të Kosovës i dëshiron Erblin Osmanit suksese të vazhdueshme dhe arritje të mëdha në karrierë", ka shkruar Ademi.

HAJDARI: MË KËRCËNUAN SE DO T'I SULMONIN PRINDËRIT E MI PASI ZGJODHA KOSOVËN



HOFFENHEIM, 2 QERSHOR - Albian Hajdari është një nga futbollistët më të rëndësishëm të Kombëtares së Kosovës. Që kur ka veshur fanellën dardane, ai është bërë pjesë kyçe e formacionit të trajnerit, Franco Foda. Hajdari, po ashtu, është duke treguar formë tejet të

lartë në Bundesliga me Hoffenheimin. Por, 23-vjeçari ka folur sërish rreth vendimit të tij për t'iu bashkuar Kombëtares së Kosovës dhe kështu duke lënë Zvicrën. Madje futbollisti ka deklaruar se ka pasur edhe fyerje dhe kërcënime nga zvicëranët. "Kishte kërcënime dhe

fyerje shumë personale. Njerëzit më shkruanin duke më thënë se e dinin ku jetoja unë dhe prindërit e mi. Se do t'i sulmonin prindërit e mi nëse nuk do të isha në shtëpi, por unë nuk i marrë shumë afër zemrës këto mesazhe në rrjetet sociale", ka thënë Hajdari.

KFF FERONIKELI MBETET PJESË E SIGURIA SUPERLIGËS SË FEMRAVE

DRENAS, 2 QERSHOR - Klubi i Futbollit të Femrave (FFK) Feronikeli ka siguruar mbetjen në Siguria Superligën e femrave pas fitores në ndeshjen e barazhit ndaj KFF Deçanit me rezultat 3:1. Ndeshja, e zhvilluar në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, nisi më mirë për skuadrën nga Deçani, e cila kaloi në epërsi në minutën e 4-t me golin e

shënuar nga Alberie Boletinaj. Megjithatë, Feronikeli ka reaguar shpejt dhe ka barazuar rezultat në minutën e 10-t përmes Diellza Gashit. Në pjesën e dytë Feronikeli ka arritur ta përmbysë rezultatit dhe ta kontrollojë rrjedhën e ndeshjes. Fillimisht, Erolina Smakiqi ka shënuar në minutën e 56-t për epërsinë 2:1, ndërsa Diellza Krasniqi ka

vulosur fitoren në minutën e 67-t, duke realizuar golin e tretë për skuadrën e saj. KFF Feronikeli e kishte mbyllur edicionin në pozitën e pestë në Siguria Superligën e femrave, ndërsa KFF Deçani kishte përfunduar në vendin e dytë në Ligën e Parë. Me këtë fitore Feronikeli ka ruajtur statusin e skuadrës së Superligës.



Inter Miami, ofertë për Pep Guardiolen

MIAMI, 2 QERSHOR - David Beckhami është gati të bëjë gjithçka që duhet për ta sjellë Guardiolen në krye të Inter Miami. Sipas "The Mirror", presidenti i Inter Miamit, David Beckham, i ka ofruar 55-vjeçarit Pep Guardiola

pozicionin e trajnerit kryesor në ekipin amerikan. Burimet kanë thënë se Guardiola është një nënshkrim i vërtetë ëndërrash për Inter Miamin dhe presidenti i klubit, David Beckham, është i gatshëm të bëjë çmos për ta

siguruar marrëveshjen e tij. Megjithatë, Guardiola e ka refuzuar ofertën, pasi nuk ka ndërmend t'i ndryshojë planet pas largimit nga Manchester City. Guardiola mbetet i përkushtuar për t'u rikthyer në futboll si trajner kryesor i një

skuadre kombëtare dhe jo i një klubi tjetër. Guardiola ka njoftuar se është larguar nga Manchester City dhe për momentin nuk ka ndërmend ta marrë drejtimin e një klubi të ri, pasi dëshiron të bëjë një pushim.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “EZ5 KOSOVO” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811910430 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo “EZ5 KOSOVO” L.L.C. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nr. 811910430 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “EZ5 KOSOVO” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811910430 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “EZ 5 ENERGY” SH.P.K. Dega në Kosovë me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811948142 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “EZ 5 ENERGY” D.O.O. podružnica na Kosovu Pristina donelo odluku o prestani rada sa nr. 811948142 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “EZ 5 ENERGY” L.L.C. branch in Kosovo with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811948142 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Prishtinë, 03.06.2026

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 81050100 me adresë: Rr. „Adem Jashari“, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.05.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **0.57 MW** ZK Prekallë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **0.57 MW** ZK Prekallë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.6336-2/25 dt. 03.12.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendim për Caktimin e Kushteve Ndërtimore nr. 11-351-40062/145 dt. 21.11.2026 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimi për Leje Ndërtimore Nr. 11-351-45958/158 dt. 30.12.2025 për “Instalimin e Sistemit Solar Fotovoltaik- me kapacitet 0.57 MW, ngastrata katastrale 00371-6, dhe 00371-7 ZK Prekallë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergetik Nr. 5723 dt. 22.04.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: elektrosystem16@gmail.com dhe LEGAL-LENCENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besart Brahimi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m.l.t. “Arkitekt Sinani” Mitrovicë.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK “11 Marsi” Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- “Restorant te Besi” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Sulejman Vokshi” në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjuraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.

- Vilson Gjyckaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

